

# Fazat dhe sfidat e integrimit en bloc apo mini BE?

**Krenar Shala**

**08.07.2016**

**Përkundër zotimit të Brukselit, Bosna & Hercegovina, Kosova dhe Maqedonia nuk kanë ardhmëri euro-atlantike në periudhën afat-shkurtër dhe afat-mesme. Thellimi i ndarjes së poleve gjeo-politike në mes të Perëndimit dhe Rusisë ka ndikuar që të ndërlikohet edhe më shumë procesi i integrimit në strukturat euro-atlantike të shteteve të sipërpërmendura.**

**Kjo faqe lihet qëllimisht e zbrazët.**

## Hyrje

Organizatat e ndryshme ndërkombëtare i vlerësojnë vendet e Ballkanit Perëndimor janë në një nivel pak a shumë të njëjtë me njëri-tjetrin sa i përket zhvillimeve socio-politike dhe konsolidimit demokratik të institucioneve dhe shoqërisë.

Vlerësimi dhe analiza e sfidave me të cilat përballen këto vende në lidhje me përmbushjen e kritereve të Kopenhagës, do të përbente një bazë solide për institucionet në Bruksel për të rritur përpjekjet (siç janë shpallur në Samitin e Berlinit dhe Vjenës) për financimin e projekteve ndër-shtetërore<sup>1</sup>, specifiku në infrastrukturë dhe energji, në mënyrë që përpjekjet e përbashkëta për të kapërcyer problemet bilaterale të lehtësohen. Nisma e re e ndërmarr nga Ministri i Jashtëm austriak, Sebastian Kurz rreth shtimit të përpjekjeve në kuadër të turit të tij në Ballkanin Perëndimor, simbolizon rëndësinë që vendet e rajonit të energjizohen në këtë drejtim.<sup>2</sup>

Në anën tjetër, procesi i anëtarësimit në BE pritet të karakterizohet me tensione dhe ndërlikueshmëri në sferën e rritjes së bashkëpunimit rajonal. Pavarësisht nga përparimet në këtë drejtim, vendet e Ballkanit Perëndimor janë të hendikepuara me mungesë të

<sup>1</sup>Nisma e 6 vendeve të Ballkanit Perëndimor rreth Axhendës së Ndërlidhjes së BE-së qëllimi i së cilës është bashkë-financimi i projekteve investuese në Ballkanin Perëndimor. [http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/policy-highlights/regional-cooperation/20150828\\_vienna\\_info\\_pack.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/policy-highlights/regional-cooperation/20150828_vienna_info_pack.pdf)

<sup>2</sup>Ministri i Jashtëm Austriak, Sebastian Kurz viziton Ballkanin Perëndimor. ([www.bmeia.gv.at](http://www.bmeia.gv.at))

gatishmërisë për të bërë kompromise për të lehtësuar procesin në mënyrë që rajoni të jetë gati për t'u integruar en bloc.

Anëtarësimi en bloc do të jetë një mënyrë më efikase për të inkurajuar vendet drejt ndërmarrjes së reformave, veçanërisht në forcimin e marrëdhënieve dypalëshe, ndërkohë, do të evitonte mundësinë për të bllokuar procesin eventual të anëtarësimit të disa vendeve që janë disa hapa prapa ose më pranë anëtarësimit.

Megjithatë, nuk mund të mohohet fakti që ekziston një dozë e frikës se ndonjë vend i Ballkanit Perëndimor, në rastin hyrjes më përpara se vendet e tjera të këtij rajoni, mund të përkeqësojë përpjekjet e ndonjë vendi tjetër në axhendën e anëtarësimit, përbën skenar seriozisht shqetësues.

Ndërsa zyrtarisht Komisioni Evropian, së bashku me shtetet anëtare, duhet të vazhdojë me politikën e saj se "anëtarësimi i vendeve të varet tërësisht nga reformat shtetit përkatës në përmbushjen e kritereve të Kopenhagës", në mënyrë që të evitohet dekurajimin e disa vendeve të cilat tashmë janë disa hapa përpara.

Ndërkohë, në qoftë se çështja ende e pasqaruar e rumbullakimit të subjektivitetit ndërkombëtar të Kosovës nuk lehtësohet me marrjen e vendimit për njohje nga 5 shtetet e BE-së; nëse partitë politike në Bosnjë dhe Hercegovinë nuk arrijnë konsensus në kuadër të nismës së re - qasja e re strategjike, e proklamuar nga Mbretëria e Bashkuar dhe Gjermania<sup>3</sup>

<sup>3</sup>Kjo nismë e Gjermanisë dhe Britanisë së Madhe u ndërmarr më 5 nëntor 2014, qëllimi i së cilës është intensifikimi i përpjekjeve për të avancuar me reformat e domosdoshme në mënyrë që vendit t'i hapet rruga drejt BE-së. (shih këtu: <https://www.gov.uk/government/speeches/bosnia-herzegovina-a-new-strategic-approach>)

- në mënyrë që të lëvizet përpara me ndërmarrjen e reformave për anëtarësim në BE; nëse partitë e opozitës dhe ato që janë në pushtet nuk arrijnë të gjejnë konsensus se si të dilet nga ngërçi politik aktual duke ofruar zgjidhje edhe për çështjen e emrit kushtetues të Maqedonisë; dhe duke pasur parasysh se dinamika e reformave të ndjekura nga vendet e Ballkanit Perëndimor mund të sfidohet seriozisht në periudhën afatmesme, BE-ja duhet të shtojë përpjekjet për të adresuar këto çështje themelore për të mundësuar atyre për të kapërcyer sfidat duke ndjekur objektivin strategjik që rajoni të integrohet en bloc më së largu deri në janar ose në korrik të 2025.

Nëse kjo është e pamundur, duhet të shqyrtohet alternativa për të mundësuar zhvillimin ekonomik rajonal përmes liberalizimit të tregut; lirisë së lëvizjes nëpërmjet heqjes së regjimit të vizave mes shteteve; heqjen e barrierave burkratike në mënyrë që të lehtësohet ndjekja e programeve arsimore nga ana e studentëve; zgjerimin e gamës së projekteve që mundësojnë përmirësimin e jetës së qytetarëve etj.

## Bosna si shtet jo-funksional

Ndërlíkueshmëria e sistemit institucional që është prodhuar si rezultat i Marrëveshjes së Dejtonit; niveli ende i ulët i besimit në mes të tre grupeve etnike; si dhe presioni nga jashtë - përkatësisht nga Serbia në njërin anë, dhe Kroacia në anën tjetër, përbëjnë faktorët kyç në krizimin e një atmosfere pa rrugëdalje. Siç do të thoshte edhe ish Përfaqësuesi i BE-së në OKB “problemi i Bosne & Hercegovinës është i pazgjithshëm”<sup>4</sup>; pohim i cili reflekton aktualitetin e gjendjes në teren.

Përkundër nismës së ndërmarr rrishtazi nga Gjermania dhe Britania e Madhe<sup>5</sup>, qëllimi i së cilës është nxitja e palëve për të filluar procesin e reformimit institucional të gjyqësisë si parakusht për zhbllokimin e procesit integruar, thirrjet gjithnjë të shpeshta të liderit të Republika Sërpskas, Milorad Dodik,<sup>6</sup> për ndarje nga Federata, vetëm se është duke e ndërlikuar edhe më shumë procesin edhe ashtu të vështirë të rrugës së vendeve të Ballkanit Perëndimor në BE.

*Kur ia shtojmë kësaj situatë të ndërlikuar edhe efektet tektonike që shkaktoi referendumi britanik për të ardhmen e këtij shteti në BE; ndikimin e vazhdueshëm rus; krizën e fundit të refugjatëve si dhe shtimin e radikalizimit fetar në rajon, përforcohet bindja dhe frika se ky rajon ende gjendet në tehtë të destabilitetit.*

Viti	Niveli i bashkëpunimit
2008	B&H nënshkroi Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit.

<sup>4</sup>Intervistë me Thomas Mayr-Harting, ish përfaqësues i BE-së në OKB

<sup>5</sup>Bosnia & Herzegovina - a new strategic approach <https://www.gov.uk/government/speeches/bosnia-herzegovina-a-new-strategic-approach>

<sup>6</sup>Pas presioneve të shumta nga vendet perëndimore dhe Serbia, Milorad Dodik i shtyrë planet për një kohë të pacaktuar për organizimin e referendumit për ndryshimet në sistemin gjyqësor në nivel republike. (shih këtu: <http://www.balkaninsight.com/en/article/bosnian-serb-leaders-puts-controversial-referendum-on-hold--02-09-2016>)

<sup>7</sup>Intervistë e David Philips, Profesor në Institutin për Studime të Drejtave të Njeriut në Universitetin Columbia, dhënë Radios Evropa e Lirë. <http://www.evropaelire.org/a/27544978.html>

Korrik 2008	B&H vuri në zbatim Axfordën Reformuese qëllimi i së cilës është evitimi i pengesave drejt zhvillimit socio-ekonomik si dhe avancimin e reformave në administratën publike dhe sistemin e gjyqësisë. Zbatimi i Axfordës Reformuese është e domosdoshme për të mundur që BE të shqyrtoj aplikimin për statusin e kandidatit.
Dhjetor 2010	Komisioni Evropian e vendosi B&H në listën e bardhë të zonës Schengen me të cilën i lejohet secilit qytetarë që të lëvizë lirshëm për një periudhë 3 mujore, pa të drejtë pune.
Qershor 2012	BE dhe B&H filluan <i>Dialogun e Nivelit të Lartë</i> <sup>9</sup> synimi i së cilës është para-pregatitja e institucioneve të B&H në kuadër të procesit integrues duke shpjeguar metodologjinë e negociatave për anëtarësim si dhe diskutimin se çka pritet nga një shtet kandidat.
Qershor 2015	Marrëveshja për Stabilizim dhe Asociim hyn në fuqi.
15 shkurt 2016	Bosna & Hercegovina aplikoj për marrjen e statusit të vendit kandidat. <sup>10</sup>

<sup>9</sup>High-Level Dialogue between B&H and EU.  
[http://europa.eu/rapid/press-release\\_MEMO-12-489\\_en.htm?locale=en](http://europa.eu/rapid/press-release_MEMO-12-489_en.htm?locale=en)

<sup>10</sup>Bosna & Hercegovica zyrtarisht aplikon për anëtarësim në BE.  
<http://www.independent.co.uk/news/world/europe/bosnia-herzegovina-files-formal-application-to-join-eu-a6874511.html>

**Marrëdhëniet bilaterale.** Sipas Raportit<sup>11</sup> të draftuar nga Komisioni Evropian, janë në nivel të knaqshëm, por mbetet ende shumë për të bërë në këtë drejtim. Problem mbetet mos-njohja e Kosovës si dhe mos-gadishmëria e të dyja vendeve për të suspenduar regjimin aktual të vizave.<sup>12</sup>

Pengesat e vazhdueshme të përcjellura me mos-gadishmërinë e institucioneve të B&H rreth realizimit të kërkesave nga ana e BE-së për ndryshimin e Kushtetutës, si rezultat i vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut apo siç njihet ndryshe rasti *Sejdić-Finci*, përbëjnë sfida të cilat e cenojnë rrugën e këtij shteti si dhe shteteve të tjera të rajonit drejt BE-së.<sup>13</sup>

### Mali i Zi – integrimi në sferën perëndimore të sigurisë

Përkundër rezistencës fillestare nga Qeveria e Malit të Zi rreth respektimit të klauzolës së Bashkimit Evropian në kontekst të legjitimitetit të rezultatit të referendumit për pavarësi, Qeveria e Malit të Zi pranoi dakordimin e ministrave të jashtëm të BE-së për formulën e rezultatit të referendumit.<sup>14</sup>

<sup>11</sup>Raporti i Përparimit, 2015. Fq. 28. Çështjet rajonale dhe obligimet ndërkombëtare.  
[http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key\\_documents/2015/20151110\\_report\\_bosnia\\_and\\_herzegovina.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2015/20151110_report_bosnia_and_herzegovina.pdf)

<sup>12</sup>Përfaqësues nga organizatat e shoqërisë civile nga të dyja vendet u mbledhën në Prishtinë për të bërë presion tek institucionet respektive që të suspendojnë regjimin aktual të vizave në mes të dy vendeve.  
<http://www.balkaninsight.com/en/article/activists-call-to-end-visas-between-kosovo-and-bosnia-02-05-2016>

<sup>13</sup>Rasti *Sejdić-Finci*, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut.  
[http://hudoc.echr.coe.int/eng/?i=001-96491#{"itemid":\["001-96491\]}](http://hudoc.echr.coe.int/eng/?i=001-96491#{)

<sup>14</sup>BE i kishte vënë kusht autoriteteve të Malit të Zi që në mënyrë që BE-ja të njohë rezultatit e referendumit për pavarësi, të paktën 50% e qytetarëve me të drejtë vote duhet të votojnë si dhe minimumum 55% e tyre duhet të deklarohen për.

Më 22 maj, 2006, zyrja e Përfaqësuesit për Politikë të Jashtme dhe Siguri të BE-së, doli me një deklaratë zyrtare me të cilën uron qytetarët e Malit të Zi rreth procesit të referendumit në Mal të Zi duke vlerësuar që rezultati është i pranueshëm në përputhje me kushtin e BE-së dhe se i nxit palët, në këtë rast, Malin e Zi dhe Serbinë që ta njohin subjektivitetin e njëra-tjetres dhe të vendosin marrëdhënie diplomatike.<sup>15</sup>

Pas këtij procesi të themelimit të shtetit, Mali i Zi vijoi rrugën e integritimit euro-atlantik.

Viti	Niveli i bashkëpunimit
2007	Mali i Zi nënshkroi Marrëveshjen për Stabilizim dhe Asociim (MSA). Kjo marrëveshje hyri në fuqi më 1 maj 2010. <sup>16</sup>
Dhjetor 2009	Qytetarët e Malit të Zi hynën në listën e bardhë të zonës Schengen, e cila ua garanton lëvizjen e lirë deri në 3 muaj qëndrim pa të drejtë pune.

<sup>15</sup>[http://www.consilium.europa.eu/uedocs/cms\\_data/docs/press\\_data/en/declarations/89678.pdf](http://www.consilium.europa.eu/uedocs/cms_data/docs/press_data/en/declarations/89678.pdf)

<sup>16</sup><http://www.delme.ec.europa.eu/code/navigate.php?Id=56>

<sup>17</sup>Raporti i Përparimit 2015. Aneksi I – Marrëdhëniet në mes të Malit të Zi dhe Bashkimit Evropian. Fq 77. [http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key\\_documents/2015/20151110\\_report\\_montenegro.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2015/20151110_report_montenegro.pdf)

<sup>18</sup>Shefi i Grupit Parlamentar të PDK-së, z. Adem Grabovci potencoi që kufiri i tanishëm nuk përkon me draftin e propozuar për demarkimin e kufirit me Malin e Zi, duke theksuar që kufiri sipas draftit do të ishte 5km në brendi të territorit të Kosovës. Njëjtë kanë deklaruar edhe deputetët nga partneri tjetër qeverisës – LDK. Deputeti Shpejtim Bulliqi, me profesion gjeograf, është deklaruar disa herë që drafti aktual i marrëveshjes është gabim dhe duhet të rishqyrtohet.

Dhjetor  
2010

Komisioni Evropian ia njohu të drejtën Malit të Zi për të qenë vend kandidat për antarësim në BE.

Qershor 2012

Bisedimet për anëtarësim filluan më 29 qershor. Sipas Raportit të Përparimit të vitit 2015, deri më tani, 20 kapituj nga 35 sa janë gjithsejt, janë hapur dhe po zhvillohen me autoritetet e Malit të Zi, duke përfshirë dhe kapitujt 23 dhe 24 mbi sundimin e ligjit. Dy nga këta kapituj: kapitulli për shkencë dhe hulumtim si dhe kapitulli për arsim dhe kulturë tashmë janë mbyllur.<sup>17</sup>

**Marrëdhëniet bilaterale.** Në kontekstin e marrëdhënieve rajonale konsiderohen përgjithësisht të mira. Çështja e demarkimit të kufirit me Kosovën ka përfunduar në gusht të vitit 2015, në margjinat e Samitit të Ballkanit Perëndimor që u zhvillua në Vjenë. Tashmë mbetet ratifikimi i tyre në parlamentet respektive. Mirëpo, bllokimi i Kuvendit të Kosovës pikërisht për këtë pikë dhe për marrëveshjen për themelimin e Bashkësisë së Komunave Serbe me Serbinë nga ana e Opozitës në Kosovë, ka bërë që ky proces të stagnoj. Edhe pas zhblokimit të Kuvendit nga ana e Opozitës, drafti i tanishëm i marrëveshjes nuk pritet që do të ratifikohet për shkak të pakënaqësive të shfaqura kohëve të fundit edhe nga ana e disa deputetëve të Pozitës.<sup>18</sup>

Ndërkohë, sa i përket bisedimeve në mes të Malit të Zi dhe Kroacisë rreth demarkimit të kufirit në mes tyre, procesi është ende në etapën fillestare.

Marrëdhëniet bilaterale me shtetet e tjera të rajonit janë duke u zhvilluar në një nivel normal.

Në Samitin e NATO-s, të mbajtur në fund të vitit që shkoi, Mali i Zi u ftua të filloj procesin e bisedimeve për antarësim. Ky proces tanimë ka hyrë në etapën e fundit: ratifikimi nga ana e shteteve anëtare,<sup>19</sup> proces i cili pritet të zgjasë jo më shumë se dy vite, në mënyrë që vendi të bëhet anëtar me të drejta të plota.<sup>20</sup>

Megjithatë, ky hap ngjalli reagime nga opozita pro-ruse e cila filloi një seri protestash për të kundërshtuar antarësimin në bllokun ushtarak ose të paktën që ky antarësim t'i nënshtrohet plebishitit popullor. Në të njëjtën kohë, opozita thekson që Qeveria duhet të jep dorëheqje edhe për shkak të keq-qeverisjes, korrupsionit, praktikave jo-demokratike si dhe zgjedhjeve të karakterizuara me manipulime.<sup>21</sup>

Kjo situatë e tensionuar politike mund të ndikojë në stagnimin e procesit integrues pasi që partia në pushtet përballet me kërkesë për dorëheqje dhe se opozita jo-domosdoshmërisht është treguar e gatshme sa i përket vazhdimit të përpjekjeve për antarësim në BE.

## Serbia – faktor kyç

Territorialisht, ekonomikisht, demografikisht dhe ushtarakisht, Serbia është shteti më i fuqishëm në Ballkanin Perëndimor. Kjo epërsi përbën rëndësi substanciale për të patur mundësinë destabilizuese të sigurisë në rajon. Potenciali destabilizues përkthehet edhe si element pozitiv në marrëdhëniet ndërkombëtare.

Ky potencial krijon avantazh karshi shteteve tjera për të rritur pazarin në rritjen e ndikimit gjeo-politik.

Së këndejmi, qëllimi strategjik, i proklamuar tashmë shumë herë i politikës së jashtme të Serbisë, është anëtarësimi në BE. Ndërkohë, partneriteti strategjik i Serbisë me Republika Sërpskën; ndikimi politik në Kosovë; marrëdhëniet e veçanta të institucioneve politike të Serbisë me Kishën, institucion fetar i cili nuk e njeh Kishën Ortodokse maqedonase; ndikimi mjaft i madh i Serbisë në qeverinë e Gruevskit në Maqedoni; përbëjnë elemente të pakontestueshme në dimenzionin apo projeksionin e politikës së jashtme serbe, si dhe doemos do t'i shërbejnë asaj për ta përshpejtuar rrugën e saj drejt BE-së.

Pra duke i shfrytëzuar këto karta diplomatike, qëllimi i Serbisë është që, në të njëjtën kohë, ta ruaj ndikimin në shtetet e sipërpërmendura. Megjithatë, kjo pashmangshëm mund të rëndoq edhe më tej rrugën e saj/tyre, edhe pse të ndërlikuar, drejt BE-së.

Viti	Niveli i bashkëpunimit
2008	Serbia nënshkroi me Komisionin Evropian Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit (MSA) dhe Marrëveshjen e Përkohshme për Tregti.
Dhjetor 2009	Serbia hyri zyrtarisht në listën e bardhë të zonës Schengen. Tre ditë më vonë, ky shtet aplikon zyrtarisht për antarësim në BE.

<sup>19</sup>Republika e Shqipërisë anëtar i parë i NATO-s i cili ratifikoi Protokollin e Traktatit të Atlantikut të Veriut për aderimin e Malit të Zi", më datën 23 qershor, 2016.

<sup>20</sup>[http://www.nato.int/cps/en/natohq/news\\_128096.htm](http://www.nato.int/cps/en/natohq/news_128096.htm)

<sup>21</sup><http://www.balkaninsight.com/en/article/anti-government-protest-spread-across-montenegro-10-05-2015-1>

Mars 2012	Serbia e merr statusin e kandidatit për antëresim në BE .
Dhjetor 2015	<p>Bisedimet për anëtarësim filluan me hapjen e kapitullit 35 (Normalizimi i marrëdhënieve me Kosovën) si dhe kapitullit 32 që ndërlidhet me kontrollin financiar.</p> <p>Shënim: BE pret që nga fillimi i janarit 2016 të hapen edhe dy kapituj tjerë (kapitulli 23* – Sistemi gjyqësor dhe të drejtat fundamentale &amp; kapitulli 24* – Drejtësia, Liria dhe Siguria), që në fakt përbëjnë edhe kapitujt më të rëndësishëm në procesin e negociatave për antarësim krahas kapitullit 35. Megjithatë, Kroacia, si vend anëtar i BE-së i ka paraqitur disa kërkesa shtesë të cilat duhet të plotësohen nga Serbia në mënyrë që vendi t'i filloi negociatat për anëtarësim.<sup>22</sup> Këto kërkesa janë marrë parasysh nga ana e Komisionit Evropian dhe janë bërë pjesë e pozicionit të BE-së gjatë hapjes së kapitullit të 23</p> <p>*Vlen të theksohet fakti që me nisjen e bisedimeve, Mali i Zi dhe Serbia (nuk do të përjashtohen as vendet e tjera kandidate dhe potenciale-kandidate) do ti nënshtrohen parimit të fillimit të bisedimeve për hapjen dhe përmbylljen e kapitujve 23 dhe 24 në fazat e para të negociatave dhe përmbylljen e tyre në fazën e fundit të negociatave. Hapja e këtyre kapitujve në fillim të procesit shihet si domosdoshmëri pasi që janë kapitujt më të vështirë për tu zbatuar.</p>

**Marrëdhëniet bilaterale.** Sa i përket nivelit të marrëdhënieve me shtetet e tjera të rajonit, Serbia ka treguar që është një aktor i cili medeomos e konsideron integrimin në BE si përparësi primare e politikës së saj të jashtme.

Sipas raportit të hartuar nga Komisioni Evropian për vitin 2015, Serbia vazhdon të luaj rol konstruktiv në rajon duke marrë pjesë aktivisht në nismat rajonale, si: Procesi i Bashkëpunimit i Evropës Jug-lindore, Procesi i Bërdos, Këshilli për Bashkëpunim Rajonal si dhe Marrëveshja e Tregtisë së Lirë e Evropës Qendrore.

Ndërkohë, demarkimi i kufirit me Kroacinë, Malin e Zi si dhe Bosne & Hercegovinën është ende në proces. Me Kosovën ende nuk ka filluar.<sup>24</sup>

### Kosova vs. Bosna

Pas shpalljes së pavarësisë, Kosova u përball me mos-gadishmërinë e Këshillit të Sigurisë së OKB-së rreth dakordimit për të pranuar Planin e Ahtisarit në bazë të të cilit edhe është shpallur akti i pavarësisë. Si rrjedhojë, Serbia, me ndihmën e miqve si Rusia e Kina, e filloi një fushatë të egër për mos-njohjen e deklaratës së pavarësisë. Kjo fushatë kulmoi me ngritjen e çështjes në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë, në Hagë.

Më 22 gusht, 2010, Gjykata e publikoi opinionin e saj se shpallja e pavarësisë së Kosovës nuk e cenon të drejtën ndërkombëtare. Si rezultat, Serbia nuk pushoi së vepruari duke e dërguar çështjen në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së e cila më shumicë votash votoi që, me ndërmjetësim të BE-së, Kosova dhe Serbia të angazhohen në fillimin e dialogut teknik për të zgjidhur çështjet që nuk prekin temat e statusit të Kosovës.

<sup>22</sup>Kroacia ia heq veton Serbisë

<https://euobserver.com/enlargement/133668>

<sup>23</sup>Për Serbinë vlenë dhe Kapitulli 35 që ndërlidhet me vazhdimin e normalizimit të marrëdhënieve me Kosovën.

<sup>24</sup>Çështjet rajonale dhe obligimet ndërkombëtare. Fq. 19. Raporti i Komisionit Evropian për Serbinë, 2015. [http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key\\_documents/2015/20151110\\_report\\_serbia.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2015/20151110_report_serbia.pdf)



Akterët e përfshirë në këtë proces insistonin që temë dialogu do të jenë vetëm çështjet teknike. Përkundër këtij zotimi, pas një periudhe, ky proces dialogues teknik avancoi në atë politik. Temat e nxehta të integritimit të veriut nën juridiksionin e Kosovës kanë bërë që Komisioni Evropian ta ndërlihdë çështjen e normalizimit gjithëpërfshirës të marrëdhënieve me Kosovën në kuadër të procesit të filluar të negociatave për anëtarësim të Serbisë në BE, pra përmes kapitullit të veçant.<sup>25</sup>

Gjithashtu, në këtë kontekst, marrëveshja për Asociim dhe Stabilizim e nënshkruar së fundmi në mes të Kosovës dhe Komisionit Evropian, përpos aspekteve teknike rreth domosdoshmërisë së reformimit të institucioneve të cilat merren kryesisht me tregtinë, sundimin e ligjit dhe rritjen e efikasitetit të administratës, thekson domosdoshmërinë e vazhdimin të dialogut të ndërmjetësuar nga BE, në mes të Kosovës dhe Serbisë. MSA dhe kapitulli 35, respektivisht, i obligon të dyja këto shtete që të vazhdojnë dialogun si të vetmen rrugë për të vazhduar procesin e antarësimit në BE.<sup>26</sup>

Ndërkaq, deri më tani, dialogu me Serbinë më shumë i ka shërbyer kësaj të fundit sesa Kosovës.<sup>27</sup> Kjo për arsyen e thjeshtë që Kosova vuan nga mungesa e njohjes së subjektivitetit të saj ndërkombëtar, duke përfshirë këtu dhe refuzimin për njohjen e pavarësisë së saj nga 5 vende të BE-së si dhe nga imazhi negativ që pasqyrohet me nivelin e lartë të korrupsionit endemik si dhe krimin të organizuar.

Sa i përket obligimeve ndërkombëtare dhe çështjeve rajonale, raporti thekson miratimin nga ana e Kuvendit të Kosovës të amandamentimit të Kushtetutës për themelimin e dhomave të veçanta si dhe Zyrës së Prokurorit të Veçant që erdhi si kërkesë e Prokurorit amerikan Williamson që ishte angazhuar për 3 vite për të hetuar akuzat e ngritura nga Dick Marty, raportues i Këshillit të Evropës, rreth krimeve që ishin kryer gjatë viteve 98'-00'.

Më tej theksohet në raport, Kosova ka filluar të antarësohet në disa organizata rajonale, megjithëse ende nuk ka arritur të antarësohet në të gjitha organizatat e tjera rajonale, siç është puna me Qendrën e Evropës Juglindore për Sundim të Ligjit.

Sa i përket nivelit të marrëdhënieve bilaterale, Kosova me Bosnën ende nuk kanë arritur ujdë të karakterit diplomatik. Për shkak që kjo e fundit refuzon ta njoh pavarësinë e Kosovës, nuk është marrë parasysh as kërkesa rreth liberalizimit të vizave në mes të këtyre shteteve.

Tani për tani, marrëdhëniet me Malin e Zi janë në nivel të knaqshëm. Pas arritjes së marrëveshjes për demarkimin e kufirit me Malin e Zi në gusht të 2015, ende nuk kanë proceduar marrëveshjet në parlamentet respektive për ratifikim. Kundërshtimi i ashpër i Opozitës në Kosovë ka shtyrë edhe disa deputetë të Pozitës që të kundërshtojnë draftin aktual të marrëveshjes duke shtuar edhe më shumë presionin që Qeveria të reflektoj në këtë drejtim.<sup>28</sup>

<sup>25</sup>Kapitulli i 35 i negociatave për antarësim Serbi-BE.

<sup>26</sup>Neni 5 i Marrëveshjes për Stabilizim dhe Asociim në mes të Kosovës dhe Bashkimit Evropian.  
<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=11239>

<sup>27</sup>Serbia lloji shumë për të parandaluar antarësimin e Kosovës në UNESCO dhe Gjykatën Ndërkombëtare të Arbitrazhit.

<sup>28</sup>Aksioni i para disa ditëve i Lëvizjes VETËVENDOSJE! me që rast u ngrit sheja kufitare e cila e ndan Kosovën me Malin e Zi, si shej proteste ndaj Qeverisë për të reflektuar për gabimin e bërë, ka bërë që Qeveria e Malit të Zi të reagoi menjëherë duke shtuar që veprimi i "personave të panjohur" ka "vënë në dyshim marrëdhëniet shumë të mira në mes të Republikës së Malit të Zi dhe Republikës së Kosovës"

Rishqyrtimi i marrëveshjes mund të prodhojë efekte të tjera të cilat mund të ndikojnë në marrëdhëniet në mes të këtyre dy shteteve. Kjo çështje ka zgjuar vëmendjen e autoriteteve në Mal të Zi, duke lënë të kuptohet që marrëveshja mund të riarranzhohej.<sup>29</sup> Ndërkohë, shkëmbimi i ambasadorëve ndërmjet këtyre vendeve, megjithë nënshkrimin e marrëveshjes për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike, ka mbetur peng si rezultat i kërkesës së Presidentit të Malit të Zi për të inkorporuar në Kushtetutën e Kosovës të drejtën për njohjen e minoritetit malazes.<sup>30</sup>

Edhe Komisioni Evropian e ka marrë çështjen e demarkacionit në konsideratë në raportin e fundit rreth zbatimit të kriterëve për liberalizim vizash me Kosovën ku i bën thirrje autoriteteve në Kosovë që të zgjidhin mos-marrëveshjet dhe të ratifikojnë marrëveshjen. Kjo çështje është vënë si kusht në vendimin e Komisionit Evropian për t'i rekomanduar Këshillit Evropian lëvizjen e lirë të qytetarëve të Kosovës drejt vendeve të Zonës Schengen.<sup>31</sup>

<sup>29</sup>Zyra për marrëdhënie me Publikun. Qeveria e Malit të Zi.

<http://www.gov.me/en/search/155301/STATEMENT-Disagreements-in-Pristina-on-the-state-border-with-Montenegro-are-Kosovo-s-internal-matter.html>

<sup>30</sup>Zyra e Presidentit të Kosovës ka marrë vendim për të emëruar një anëtar të bashkësisë malazese si pjesë e Këshillit Konsultativ për Komunitete.

<sup>31</sup>European Council proposes visa-free travel for the people of Kosovo. [http://europa.eu/rapid/press-release\\_IP-16-1626\\_en.htm](http://europa.eu/rapid/press-release_IP-16-1626_en.htm)

Marrëdhëniet me Maqedoninë mbeten të mira, poashtu. Përkundër incidenteve të vitit të kaluar në Kumanovë, Qeveria e Kosovës bëri thirrje për qetësimin e situatës si dhe rritjen e vëmendjes ndaj zbatimit në plotëni të Marrëveshjes së Ohrit, si bazë për qetësimin e tensioneve në mes të dy grupeve më të mëdha etnike: maqedonase dhe shqiptarëve.

## Maqedonia – pa identitet?

Kriza e tanishme politike si dhe bllokimi nga vendet fqinje anëtare të BE-së dhe NATO-s,<sup>32</sup> ka ndërlikuar edhe më shumë qorrsokakun ku gjendet tashmë 10 vite, Maqedonia.

Ka 11 vite prej se Maqedonia ka marrë statusin e vendit kandidat. Të rikujtojmë që me hyrjen e Shqipërisë dhe Kroacisë në NATO, Greqia bllokoi ftesën për antarësimin e Maqedonisë për shkak të dështimeve të një-pas-njëshme në negociatat për emrin e kësaj republike. Shteti fqinjë, pra Greqia, konsideron që Maqedonia ka ambicie territoriale ndaj saj për shkak të faktit që ky emër përkon me emrin e një rajoni verior të Greqisë. Greqia deklaroi që shteti i Maqedonisë po mundohet të vjedhë identitetin dhe se rruga e saj drejt proceseve integruese euro-atlantike do të jetë e bllokuar për sa kohë kjo e fundit nuk ndryshon qëndrim.

Rishtazi, kryeministri i tanishëm i Maqedoninë, Nikolla Gruevski deklaroi që shteti maqedonas është i gatshëm të gjejë zgjidhje për emrin në mënyrë që të zhblllogohet rruga e integritit. Gjetja e zgjidhjes pastaj do të nënshtrohej referendumit popullor.<sup>33</sup>

<sup>32</sup>Greqia dhe Bullgaria.

<sup>33</sup><http://www.theguardian.com/world/2015/dec/16/macedonia-open-to-changing-its-name-to-end-24-year-dispute-with-greece>

Ndërkohë, kriza politike në Maqedoni është një problem tjetër i cili e bllokoi rrugën e Maqedonisë drejt integritimit. Mos-zbatimi në plotëni i marrëveshjes së Ohrit, e cila i dha fund konfliktit ndër-etnik, vazhdon të ngjallë tensione në mes të etniteteve kryesore: maqedonasve dhe shqiptarëve. Të rikujtojmë faktin që edhe Shqipëria<sup>34</sup> iu ka bashkuar Greqisë dhe Bullgarisë në bllokimin e rrugës së saj në NATO si rezultat i ngurrimit të Maqedonisë për të zbatuar Marrëveshjen e Ohrit.

Mos-njohja e Kishës Ortodokse maqedonase nga Kisha ortodokse serbe përbën një tjetër element i cili mund t'i kushtoj negativisht marrëdhëniet në mes të këtyre vendeve. Edhe pse qeveria e tanishme e kryeministrit Gruevski gëzon marrëdhënie të shkëlqyera me qeverinë në Beograd,<sup>35</sup> marrëdhëniet mund të cenohen nëse eventualisht kemi ndërrim të subjekteve politike që e udheheqin qeverinë në të dy anët.

Viti	Niveli i bashkëpunimit
Dhjetor 2005	Maqedonia është shteti i parë i Ballkanit Perëndimor, së bashku me Kroacinë, që iu statusi i kandidatit nga Këshilli Evropian më 16 dhjetor, 2005.

<sup>34</sup><http://news.yahoo.com/albania-threatens-veto-macedonias-nato-bid-185836194.html>

<sup>35</sup>Qeveritë e këtyre dy vendeve kanë organizuar edhe mbledhje të përbashkëta qeveritare.

<sup>36</sup>Ky dialog ka qëllim të ndjek procesin e përgatitjeve për antarësim mirëpo palët nuk marrin kurrfar obligimi për antarësim.

Dhjetor 2009	Qytetarët e Maqedonisë hyjnë në listën e bardhë të zonës Schengen, e cila ua garanton lëvizjen e lirë deri në 3 muaj qëndrim pa të drejtë pune.
Tetor 2009	Komisioni Evropian i propozon Këshillit Evropian që të hap negociatat për antarësim.
Mars 2012	Duke e marrë parasysht bllokadën politike të vënë nga ana e Greqisë (dhe jo zyrtarisht edhe nga Bullgaria), Komisioni Evropian filloi dialogun e nivelit të lartë për antarësim <sup>36</sup> me Shkupin.

## Shqipëria

Në qershor të vitit 2014, Shqipëria zyrtarisht mori statusin e vendit kandidat për antarësim në Bashkimin Evropian. Për të bërë të mundur hapjen e negociatave për antarësim, Komisioni Evropian i ka kërkuar Shqipërisë që të fokusohet në përmbushjen e 5 kriterëve: krijimin e një administrate profesionale dhe të depolitizuar; forcimin e pavarësisë së institucioneve të drejtësisë; luftën kundër korrupsionit; luftën kundër krimit të organizuar, dhe; mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të njeriut.<sup>37</sup>

Përpos këtyre kriterëve, shteti fqinj – Greqia, ka paralajmëruar që rruga e Shqipërisë drejt Brukselit varet edhe nga suksesi i Shqipërisë në tejkalimin e pengesave si: demarkimi i kufirit detar – proces i cili ka mbetur pezull si pasojë e vendimit negativ të Gjykatës Kushtetuese; çështja e toponimeve, si dhe shfuqizimi i ligjit të luftës, i cili ende është në fuqi, përkundër antarësimit të Shqipërisë në NATO.<sup>38</sup>

<sup>37</sup><http://www.integrimi.gov.al/al/newsroom/deklarata-per-shlyp/pese-prioritetet-per-statusin-ja-masat-konkrete-te-qeverise&page=1>

<sup>38</sup><http://www.shekulli.com.al/p.php?id=286345>

Në vizitën e fundit që i bëri Shqipërisë, ministri i jashtëm grek, bëri të qartë që rruga e Shqipërisë drejt BE-së nuk do të jetë e lehtë nëse Shqipëria nuk tejkalon problemet e mbetura me fqinjin jugor.<sup>39</sup>

Viti	Niveli i bashkëpunimit
2009	Hyn në fuqi Marrëveshja për Stabilizim dhe Asociim me BE-në. Në të njejtin muaj, përkundër zërave nga institucionet e BE-së që të mos aplikoj për shkak të mos-pjekjes së kushteve, Shqipëria aplikoi për antarësim.
Dhjetor 2010	Së bashku me Bosne e Hercegovinën, Shqipëria u pranua në listën e bardhë të Zonës Schengen, nga ku qytetarët e Shqipërisë mund të udhëtojnë lirshim brenda zonës Schengen deri në 90 ditë pa të drejtë leje pune.
Qershor 2014	Shqipëria e fitoi statusin e vendit kandidat.

Përpyqjeve të shtetit shqiptar rreth përmbushjes së obligimeve u janë shtuar rrishtazi është Ambasada Amerikane në Tiranë, që sipas ambasadorit amerikan

Donald Lu - ka marr udhëzime nga Departamenti Amerikan dhe Shtëpia e Bardhë që të ofroj palët në dialog në mënyrë që të procedohet sa më shpejt me ndryshimet kushtetuese të domosdoshme për të filluar reformën më të rëndësishme që nga rënia e diktaturës. Përkushtimi i diplomacisë amerikane dëshmohej edhe me vizitën e Sekretarit amerikan të shtetit, John Kerry, qëllimi i së cilës ishte t'i nxisë palët që të shtojnë përpjekjet për të përfunduar reformën në drejtësi.<sup>40</sup> Për këtë qëllim, Tiranën e vizitoi edhe ministri i jashtëm german, Steinmeier e cili nxiti palët që të gjejnë konsensus dhe të miratojnë reformën aq shumë të nevojshme për të ardhmen evropiane të Shqipërisë.<sup>41</sup>

Përpos kësaj, institucionet vendore janë duke u asistuar edhe nga Komisioni i Venedikut i cili ka paraqitur para palëve një draft-dokument për të mundësuar reformat në këtë sektor të rëndësishëm.

Sidoqoftë, debatet e shumta në mes të dy taboreve politike dhe mos-pajtimet kanë ndikuar që durimi i BE-së të venitet. Kryetari i Komisionit të Çështjeve Evropiane në Bundestag, Gunther Krichbaum ka deklaruar me tona të ashpra rreth ngecjes së miratimit të reformës në drejtësi duke shtuar "...por në çoftë se ne, në fund të ditës na krijohet përshtypja që kjo reformë nuk është e dëshiruar, që lufta ndaj korrupsionit nuk funksionon ashtu siç duhet, atëherë edhe ne në fund të ditës mund të marrim vendimin që t'ju hesim statusin e vendit kandidat... data 21 korrik është datë vendimtare përse a i përket kësaj çështjeje sepse duhet të marr një vendim"<sup>42</sup> në kohën kur Këshilli Evropian do të jetë në pushim veror për t'u rimbledhur në sesionin vjeshtor për të vendosur datën rreth fillimit të bisedimeve për antarësim.

<sup>39</sup>Po, aty.

<sup>40</sup>Sekretari Kerry udhëton për në Mynhen, Shqipëri dhe Rancho Mirage.

<sup>41</sup>Steinmeier në Tiranë për reformën në drejtësi <http://www.dw.com/sq/steinmeier-n%C3%AB-tiran%C3%AB-pa-reform%C3%ABn-n%C3%AB-drejt%C3%ABsi-nuk-p%C3%ABrshpejtohet-integrimi-n%C3%AB-be/a-19329773>

<sup>42</sup>Gjermania kërcënon Shqipërinë. "Mund t'ju heqim statusin". <http://infoalbania.al/gjermania-kercenon-shqiperine-mund-tju-heqim-statusin/>

Marrëdhëniet rajonale. gjithnjë sipar Raportit për Shqipërinë të përpiluar nga Komisioni Evropian për vitin 2015, Shqipëria vlerësohet si aktor i dobishëm në këtë sferë.

Vlerësohet fakti që diplomacia shqiptare është e angazhuar seriozisht në forcimin e marrëdhënieve me shtetet e tjera të rajonit. Shqipëria gëzon raporte të shëndosha bashkëpunimi me të gjitha shtetet e rajonit. Raporti thekson edhe fillimin e një epoke të re të bashkëpunimit pas një periudhe të gjatë të një bashkëpunimi të tensionuar me Serbinë.

Vizitat e ndërsjella të dy kryeministrave në kryeqytetet respektive, përbëjnë jehonë në fillimin e një etape të re marrëdhëniesh, mirëpo incidentet e fundit që ndodhën në fushën e futbollit në mes të përfaqësueses së Shqipërisë dhe Serbisë, shpërfaqën marrëdhëniet e tensionuara që mbretërojnë ende dhe që datojnë me dekada të tëra.<sup>43</sup>

## Përfundime

Ndërlikueshmëria dhe historiku tensionues në mes të shteteve të Ballkanit Perëndimor është jo vetëm i vështirë për tu zgjidhur, por dhe mjaft i paparashikueshëm në periudhën afat-mesme dhe afat-gjatë. Kur këtij realiteti historiko-politik ja shtojmë edhe efektin tektonik i prodhuar si rezultat i verdiktit popullor në Britaninë e Madhe rreth ardhmërisë së këtij shteti në BE, meqë rast shumica u deklaruan që shteti i tyre duhet të largohet nga ky bllok, anëtarësimi i rajonit të Ballkanit dhe në veçanti anëtarësimi si politikë është ndërlikuar edhe më tej dhe do të vazhdojë edhe për një kohë relativisht të gjatë të jetë jo e randsishme për qytetarët e vendeve të BE-së.

*Karrota dhe Shkopi* është ofruar si politikë për këtë qëllim nga vendet e Bashkimit Evropian më 2003 në Selanik dhe që nga ajo kohë, përkundër pengesave të shumta – të jashtme

dhe të brendshme, ky rajon ka gëzuar një përparim të hovshëm në fushën e përmirësimit të marrëdhënieve bilaterale dhe multilaterale, në njërin, si dhe është energjizuar përpjekja për zhvillimit të diversifikuar ekonomik, sundim të ligjit për të gjithë si dhe demokratizimin institucional dhe shoqëror.

Që nga Samiti i Selanikut më 2003, nga ku dhe zyrtarisht këtij rajoni iu dha perspektiva e integritimit në BE, shtetet e rajonit i kanë intensifikuar më shumë së kurrë përpjekjet për zbatimin e kritereve të cilat ndihmojnë në shërimin e plagëve nga e kaluara duke hapur një faqe të re të bashkëpunimit të ndërsjellë dhe forcimit të mirëbesimit.

Përkundër këtyre zhvillimeve, historia e trishtë e urrjetëve ndër-etnike ka lënë gjurmë të cilat vështirë tejkalohe.

Përpjekjet e Forcave të Armatosura të Kroacisë për të blerë armë – raketa tokë-ajër-tokë me një rreze veprimi prej 300 kilometrash në njerën anë, si dhe kërkesave e Serbisë për tu pajisur me armë të tilla nga Federata Ruse në anën tjetër; deklaratat e Ministrisë të Punëve të Jashtme të Serbisë që Kosova është vatër e ISIS-it duke përfshirë dhe nismat e saja diplomatike për të parandaluar antarësimin e Kosovës në organizmat ndërkombëtar;<sup>44</sup> kërcënimi i vazhdueshëm për secesion nga liderët e Republika Sërspkas, përpjekjet e partive opozitare në Mal të Zi për të frenuar antarësimin e saj në NATO, mos-gadishmëria e Greqisë dhe Bullgarisë për të hapur rrugën e Maqedonisë për të avancuar drejt Brukselit, përbëjnë disa nga lëvizjet të cilat nevojiten të marrin vëmendjen më të madhe të Washingtonit dhe Brukselit.

<sup>43</sup>[http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key\\_documents/2015/20151110\\_report\\_albania.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2015/20151110_report_albania.pdf)

<sup>44</sup>Gjykata Ndërkombëtare e Arbitrazhit dhe UNESCO.

Ndërkohë, etapat e përparimit drejt integritit nuk dallojnë shumë tek shtetet e rajonit. Mali i Zi gjendet në një situatë më të favorshme se vendet e tjera. Negociatat për antarësim i ka hapur gjatë mesit të vitit 2012 dhe nëse nuk përballet me ndonjë sfidë të jashtëzakonshme, në fillimit të vitin 2020 pritet të bëhet anëtar i ri i BE-së.

Vendet më të rrezikuara nga mungesa e prespektivës për antarësim janë Bosne&Hercegovina, Kosova dhe Maqedonia. Përderisa është në fuqi traktati i BE-së i cili ua siguron vendeve anëtare të drejtën e vetos sa i përket antarësimin të vendeve të reja në bllokun evropian dhe nëse gjërat lëvizin në drejtimin e njejtë – si deri më tani, atëherë nuk është e sigurtë që këto tre shtete do të jenë në periudhën afat-mesme apo afat-gjatë anëtare të BE-së.

Ndërkohë, Shqipëria dhe Serbia, edhe pse me shumë sfida, gjenden në një situatë më të volitshme dhe nëse nuk përballen më ndonjë situatë të jashtëzakonshme të zhvillimeve të brendshme dhe të jashtme në rajon, këto shtete pritet t'i bashkohen bllokut evropian brenda periudhës së vitit 2025. Mirëpo, duke u bazuar në nivelin e marrëdhënieve në mes të shteteve të Ballkanit Perëndimor, Serbia, me gjasë, do të ballafaqohet me ngecje në rrugën e saj dhe kjo ngecje pastaj, duke e marrë parasysh ndikimin që ka Serbia në këto shtetet, pashmangshmërisht do të ndikojë që edhe rruga e këtyre shteteve të ndërlikohet. Prandaj, zgjidhja më e volitshme për vendet e këtij rajoni dhe për BE-në në tërësi, është integrimi *en bloc*.

## Rekomandimet

Nisma e fundit e kancelares gjermane - Samiti i Berlinit dhe i Vjenës, i cili u pasua me Samitin e Parisit në korrik të këtij viti, duhet jo vetëm të nxisë vendet që të vazhdojnë këtë rrugë por edhe duhet të kihet

parasysh specifikat të cilat, nëse nuk merren seriozisht në konsideratë, procesi mund të përcillet me sfida ku shtetet e ndryshme mund të bllokojnë hyrjen e vendeve të cilat janë prapa në kuptimin e integritit. Mali i Zi, Serbia dhe Shqipëria nuk kanë sfida sa i përket subjektivitetit të brendshëm ndërkombëtar dhe administrativ siç kanë Bosna dhe Hercegovia, Kosova dhe Maqedonia.

- ▶ Duke e marrë parasysh potencialin zhvillimor, të sigurisë si dhe ndikimin diplomatik e politik të Serbisë, osht jetike që ti bëhet presion që të ndihmojë përpjekjet për reformat e domosdoshme të prira nga Gjermania dhe Britania e Madhe<sup>45</sup> në mënyrë që të mundësohen ndryshimet e propozuara kushtetuese në Bosne & Hercegovinë në mënyrë që vendi të jetë i denjë për të vazhduar me fazat e ardhshme të integritit.
- ▶ Për shkak të një të kaluar historike si dhe për shkak të pozicionit të tyre gjeografik, Sllovenia, Kroacia, Hungaria dhe Bullgaria kanë interesa jetike në këtë proces, poashtu. Ato kanë mundësinë dhe potencialin që të ndikojnë që rruga e të gjitha vendeve të jetë e sigurtë. Pra, përmes rritjes së presionit të tyre, veçanërisht karshi Serbisë për të mos-sabotuar Bosne dhe Hercegovinën, Malin e Zi, Maqedoninë dhe Kosovën, këto shtete anëtare të BE-së duhet të përqëndrojnë vëmendjen drejt zhblokimit të rrugës së vendeve të rajonit, si dhe të insistojnë që rruga më e mirë është integrimi *en bloc*.
- ▶ Duke e marrë parasysh që interesi gjeo-strategjik i Serbisë në Ballkan është që të kontrollojë territor sa më shumë që është e mundur pa marrë parasysh gjendjen e rëndë socio-ekonomike të qytetarëve të saj si dhe atyre të Bosnes, duhet të reflektoj që një model i tillë i Bosnes jo vetëm se nuk i shërben qytetarëve të Bosnes, por as të Serbisë.

<sup>38</sup>Nisma e re strategjike.

- ▶ Pra, duhet të reflektohet që të ndryshohet marrëveshja për krijimin e Bashkësisë së Komunave Serbe në Kosovë konform vendimit të Gjykatës Kushtetuese që me verdiktin e saj, e hodhi poshtë këtë marrëveshje.
- ▶ Duke e marrë parasysh pozicionin shumë shqetësues dhe të ndjeshëm të Bosne&Hercegovinës, Kosovës dhe Maqedonisë, shtetet anëtare të BE-së duhet ta shqyrtojnë opcionin e futjes nën monitorim strikt,<sup>46</sup> pra përmes një mekanizmi që do të shërbej që rruga e këtyre vendeve drejt BE-së të përshpejtohet në linjë me Malin e Zi, Serbinë dhe Shqipërinë.
- ▶ Shtetet anëtare të BE-së, në koordinim me Washingtonin, duhet ti forcojnë përpjekjet e përbashkëta që të ushtrojnë trysni tek grupet etnike në Bosne dhe Hercegovinë për të mundësuar ndryshimet e nevojshme kushtetuese; në Maqedoni - për të tejkaluar krizën e tanishme politike e cila ka ardhur, përpos tjerash, edhe nga humbja gjithnjë e më shumë e prespektivës së këtij vendi në procesin integruar si dhe Kosovës - duke i bërë trysni shteteve të BE-së të cilat refuzojnë ta njohin subjektivitetin ndërkombëtar të saj - që ta ndërmarrin hapin e njohjes.
- ▶ Samiti i Parisit duhet të zgjerojë gamën e fushave ku duhet ti ipet rëndësi edhe fushës së sundimit të ligjit si dhe konsolidimit demokratik të institucioneve, krahas projekteve infrastrukturore dhe energjetike për të cilat palët tashmë janë dakorduar për ndërmarrjen e nismave rajonale.
- ▶ Zgjidhja më e mirë për të tejkaluar sfidat specifike të këtij rajoni është integrimi en bloc brenda vitit 2025. Të kujtojmë që çdo valë integruese e shteteve të ish bllokut të lindjes, është karakterizuar me dallimeve në vendet aspirante. Pra, edhe shtetet e rajonit të Ballkanit Perëndimor nuk duhet t'iu mohohet kjo e drejt për të mirën e sigurisë dhe prosperitetit të këtyre vendeve si dhe interesit të përgjithshëm të BE-së.
- ▶ Nëse kjo zgjidhje nuk është e mundur për arsye të ndryshme, atëherë liderët e vendeve të rajonit duhet të shqyrtojnë mundësinë për tu integruar mes vete, përkatësisht të shtjellojnë opcionet në liberalizimin e tregut, heqjen e pengesave burokratike për lëvizjen e lirë të qytetarëve si dhe mundësimin që studentët të kenë mundësi të studjojnë lirshëm në universitetet e këyre vendeve pa pengesa.

<sup>46</sup>Duke iu referuar shembullit të Rumanisë dhe Bullgarisë pas antarësimit të tyre në BE, përkatësisht themelimit të Mekanizmit të Veçant për Bashkëpunim dhe Verifikim nga ana e BE-së.  
[http://ec.europa.eu/cvm/index\\_en.htm](http://ec.europa.eu/cvm/index_en.htm)